



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 840/2025

Drejtuar: Z. Gazmend Hoxha, drejtor i përgjithshëm
Policia e Kosovës

Kopje: Z. Xhelal Sveçla, ministër në detyrë
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 24 korrik 2026

Qëllimi i raportit

1. Avokati i Popullit, më 4 korrik 2025, hapi hetime sipas detyrës zyrtare bazuar në raportimin e portalit “Sinjali.com”¹, të datës 4 korrik 2025, me titullin: “Ky është personi që dyshohet se u vetëengulfatë në qelinë e ndalimit në Suharekë”.
2. Qëllimi i hetimit të këtij rasti është shqyrtimi i rrethanave që çuan në vdekjen e personit të ndaluar N. K. në qelinë e ndalimit në Suharekë, duke vlerësuar nëse autoritetet kompetente i përmbushën obligimet e tyre ligjore dhe kushtetuese për mbrojtjen e së drejtës për jetë. Hetimi synon të analizojë nivelin e kujdesit, mbikëqyrjes dhe masave parandaluese të ndërmarra nga organet përgjegjëse, si dhe të verifikojë nëse u respektuan standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për trajtimin e personave të privuar nga liria, përfshirë detyrimin për zhvillimin e një hetimi efektiv në rastet e vdekjeve në ndalim.

Kompetencat e Avokatit të Popullit

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.” Kurse në paragrafin 3 përcakton: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe ti paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”
4. Kushtetuta, në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”
5. Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 4, përcakton: “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime [...] me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashitësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”
6. Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1, përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:
 - “Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (pika 2);
 - të rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (pika 5);
 - t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (pika 6);

¹<https://sinjali.com/ekskluzive-ky-eshte-personi-qe-dyshohet-se-u-vetengulfate-ne-qeline-e-ndalimit-ne-suhareke/>

- të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (pika 7);
 - të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit si dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës (pika 8);
 - t'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv (pika 9). ”
7. Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 17 përcakton se Avokati i Popullit, ka këto përgjegjësi:
- “1. Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (në tekstin e mëtejshëm: MKP).
2. Në kuadër të përgjegjësi si MKP, Avokati i Popullit është i obliguar që:
- 2.1. të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut;
- 2.2. në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit të krijojë një mekanizëm të veçantë që do të kryejë të gjitha funksionet e MKP. Personeli i këtij mekanizmi, përveç juristëve duhet të përfshijë profesionistë të fushave të ndryshme, posaçërisht mjekë, psikologë dhe punëtorë social me përvojë në këtë fushë.
3. Ekspertët dhe personat e specializuar të angazhuar nga Avokati i Popullit për nevojat e MKP-së, duhet të kenë të drejtat dhe obligimet e njëjta sikurse personeli tjetër i Avokatit të Popullit, përfshirë të drejtën për të vizituar vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, për fotografim dhe incizim radio dhe audio vizuele, të gëzojnë mbrojtjen nga ndërhyrja e jashtme në punën e tyre, si dhe të drejtën që të mos japin të dhëna, informata apo sqarime për gjetjet e tyre gjatë kryerjes së detyrave të tyre në këtë fushë.
4. Gjatë kryerjes së funksionit si MKP, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë të drejtë qasjeje në informatat për gjendjen shëndetësore të personave të privuar nga liria, përfshirë edhe qasjen në dosjet e tyre mjekësore, me pajtimin e tyre, si dhe të dhënat personale të këtyre personave.
5. Avokati i Popullit mund të jap rekomandime për përputhshmërinë e ligjeve, dhe akteve të tjera nënligjore apo administrative, udhëzuesve dhe të praktikave të aplikuara në Kosovë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues.
6. Avokati i Popullit duhet të bashkëpunojë me mekanizmat ndërkombëtar dhe vendor në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues.

7. Avokati i Popullit mund të jap sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të tyre. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon t'i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.”

Përshkrimi i çështjes

8. Ky raport u iniciua sipas detyrës zyrtare, duke u bazuar në raportimet e mediave të shkruara dhe elektronike, sipas të cilave, më 4 korrik 2025, në qelinë e ndalimit në Suharekë, një person me inicialet N. K. dyshohet se i dha fund jetës duke u vetëngulfatur gjatë kohës sa ishte në ndalim. Sipas raportimeve, N. K., 46 vjeç, u ndalua me vendim të prokurorit për veprat penale “Dhunë në familje” dhe “Sulm”. Sipas të dhënave fillestare, dyshohet se akti ndodhi brenda qelisë gjatë qëndrimit të tij në ndalim. Pavarësisht ndërhyrjes së menjëhershme të zyrtarëve policorë dhe ekipit emergjent mjekësor, ai nuk arriti të mbijetonte dhe vdekja e tij u konstatua në vendin e ngjarjes nga mjeku kujdestar. Në trajtimin e rastit u përfshinë Prokuroria, e cila doli në vendin e ngjarjes, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), i cili filloi hetimet për sqarimin e rrethanave, si dhe njësitë e forenzikës, të cilat kryen ekzaminimet dhe dokumentimin përkatës. Trupi i të ndjerit u dërgua për obduksion në Institutin e Mjekësisë Ligjore, ndërsa hetimet janë ende në vijim me qëllim të ndriçimit të plotë të kësaj ngjarjeje.

Veprimet e Avokatit të Popullit

9. Më 4 korrik 2025, Institucioni i Avokatit të Popullit, përmes adresës zyrtare elektronike, iu drejtua Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), duke kërkuar informacione lidhur me rastin e raportuar nga portali “Sinjali”, sipas të cilit dyshohej se një person humbi jetën si pasojë e vetëngulfatjes në Qendrën e Ndalimit në Suharekë.
10. Më 7 korrik 2025, përmes adresës elektronike, pranua përgjigje nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), i cili njoftoi se, në kuadër të autorizimeve ligjore, rekomandoi suspendimin e tre zyrtarëve policorë të Stacionit Policor në Suharekë (një rreshter dhe dy zyrtarë policorë), të gjithë pjesë e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren. Suspendimi u kërkuar në interes të hetimit, pas vdekjes së një personi të ndaluar, i cili dyshohej se u vetëngulfat në dhomën e ndalimit. Bazuar në hetimet paraprake dhe përgjegjësitë e zyrtarëve në fjalë, ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se, me veprimet ose mosveprimet e tyre, mund të kenë pasur neglizhencë në përmbushjen e detyrave zyrtare, veçanërisht në aspektin e garantimit të sigurisë së personit të ndaluar. Kjo masë e përkohshme u ndërmor për të mbrojtur integritetin e hetimit dhe për të shmangur çdo ndikim të mundshëm në procesin hetimor. IPK-ja, në koordinim me Prokurorinë e Shtetit, njoftoi se do të vazhdojë me veprime të tjera hetimore për ndriçimin e plotë të rrethanave të rastit, i cili aktualisht trajtohet si hetim i vdekjes.
11. Më 11 korrik 2025, ekipi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP) realizoi një vizitë në Qendrën e Ndalimit në Suharekë, ku zhvilloi një takim me komandantin e stacionit dhe mori informacione lidhur me rrethanat e vetëngulfatjes së personit të ndaluar. Gjatë vizitës, ekipi u informua për mungesën e mbikëqyrjes së dedikuar të qendrës së ndalimit, vendosjen e monitorit të kamerave në një distancë të konsiderueshme nga zyrtari policor në dhomën e dispeçerit, mungesën e një zyrtari përgjegjës për dhomat e ndalimit, si dhe mosplotësimin e tërësishëm të dokumentacionit

policor për personin e ndaluar. Gjatë vizitës në qendrën e ndalimit, Policia i ofroi MKP-së bashkëpunim të plotë. Ekipi pati qasje të menjëhershme në të gjitha hapësirat e stacionit policor. Atij iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për kryerjen e detyrës, si dhe qasje në të gjitha dokumentet e kërkuara.

12. Më 17 korrik 2025, përmes adresës elektronike, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit iu drejtua Prokurorisë Themelore në Prizren, duke kërkuar informacione mbi veprimet e ndërmarra deri në atë kohë, nëse u urdhërua ndonjë ekspertizë mjeko-ligjore lidhur me rrethanat e vdekjes, nëse zyrtarëve policorë iu caktua masa e paraburgimit, si dhe në cilin stad gjendeshin hetimet e rastit.
13. Më 18 korrik 2025, pranua përgjigje nga Prokuroria Themelore në Prizren, e cila njoftoi për veprimet e ndërmarra deri në atë kohë. Sipas informatave të Prokurorisë, më 4 korrik 2025 u lëshua urdhëresa për autopsinë e viktimës N. K., më 9 korrik 2025 u lëshua urdhri i përkohshëm i ndalimit dhe, po atë ditë, u parashtrua kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar, ndërsa më 10 korrik 2025, Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda lëshoi urdhrin ndalues përfundimtar.
14. Më 13 janar 2026, përmes adresës elektronike, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit iu drejtua IPK-së, duke kërkuar informacione nëse përfundoi hetimi lidhur me rastin e vetëvrasjes në Qendrën e Ndalimit në Suharekë.
15. Më 15 janar 2026, përmes adresës elektronike, pranua përgjigje nga IPK-ja, sipas së cilës, lidhur me rastin e vetëvrasjes në Qendrën e Ndalimit në Suharekë, hetuesit kryen verifikimin e ngjarjes, analizuan materialet dhe incizimet e stacionit policor dhe nuk gjetën elemente të veprës penale nga ana e zyrtarëve policorë. Bazuar në rezultatet e hetimit, IPK-ja përfundoi hetimin dhe rekomandoi masa disiplinore ndaj tre zyrtarëve policorë për shkelje të rënda disiplinore.

Instrumentet relevante ligjore

16. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 21, paragrafët 2 dhe 3, përcakton: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*
17. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, përcakton: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”*
18. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 23, përcakton: *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”*
19. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 25, paragrafi 1, përcakton: *“Secili individ gëzon të drejtën për jetën.”*
20. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 27, përcakton: *“Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.”*
21. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29, paragrafi 1, përcakton: *“Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente si në vijim:*

- *Pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale [...];*
 - *Për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë, [...].”*
22. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 53, përcakton: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
23. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj)², në nenin 2 (E drejta për Jetë), përcakton: *“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.”*
24. KEDNj-ja, në nenin 3 (Ndalimi i Torturës), shprehimisht përcakton: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.”*
25. KEDNj-ja, në nenin 5 (E drejta për Liri dhe Siguri), përcakton: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.”*

Analiza ligjore

26. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 25, paragrafi 1, garanton: *“Secili individ gëzon të drejtën për jetën.”* Kjo dispozitë e vendos të drejtën për jetën në themel të rendit kushtetues dhe në qendër të sistemit të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore. E drejta për jetën konsiderohet e pacenueshme dhe me karakter absolut, nga e cila nuk lejohet asnjë kufizim apo shmangie, në asnjë rrethanë. Për rrjedhojë, shteti nuk ka vetëm detyrimin negativ për të mos cenuar jetën, por edhe detyrimin pozitiv për të ndërmarrë masa aktive dhe efektive për mbrojtjen e saj, veçanërisht në situatat kur ekziston rrezik për integritetin fizik ose për jetën e individit.
27. Neni 2 i KEDNj-së garanton mbrojtjen ligjore të së drejtës për jetën dhe e obligon shtetin jo vetëm të përmbahet nga privimi arbitrar i jetës, por edhe të ndërmarrë masa konkrete parandaluese në rastet kur autoritetet kanë dijeni ose duhet të kenë dijeni për ekzistimin e një rreziku real dhe të parashikueshëm për jetën e një personi.
28. GjEDNj-ja përcakton se shteti ka detyrim pozitiv të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e individëve brenda juridiksionit të tij, duke marrë *“masat e nevojshme për mbrojtjen e një të drejte”*, ose, më saktë, *“të miratojnë masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave të individit”*.
29. Gjithashtu, neni 3 i Konventës përcakton se askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturës ose trajtimit çnjerëzor apo degradues, çka përfshin edhe detyrimin për të siguruar trajtim dinjitoz dhe mbrojtje nga vetëdëmtimi, veçanërisht për personat e ndaluar. Neni 5 i Konventës dhe neni 29 i Kushtetutës garantojnë të drejtën për liri dhe siguri personale, duke përcaktuar se çdo privim i lirisë duhet të bëhet në përputhje me ligjin dhe me garancitë procedurale.
30. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcaktuar se, kur ekziston një rrezik i parashikueshëm për jetën e një personi në ndalim, autoritetet kanë detyrimin të ndërmarrin masa konkrete për ta parandaluar atë rrezik, përfshirë mbikëqyrjen e vazhdueshme, vlerësimin e rrezikut dhe zbatimin e protokolleve të qarta të veprimit. Në

² Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqi

këtë kuadër, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) thekson rëndësinë e identifikimit të hershëm të personave vulnerabilë dhe të zbatimit të masave specifike parandaluese, me qëllim të sigurimit të integritetit fizik dhe të shëndetit të tyre.

31. Neni 27 i Kushtetutës, si dhe neni 3 i KEDNj-së, ndalojnë torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor apo degradues. Mungesa e mbikëqyrjes adekuate dhe e dokumentimit të plotë policor mund të ngrejë shqetësime lidhur me standardin e trajtimit dhe garancitë procedurale të zbatuara ndaj personit të ndaluar.
32. Në rastin *S. F. v. Switzerland* - 23405/16³, GjEDNj-ja theksoi se autoritetet e dinin ose duhej ta dinin rrezikun, por nuk morën masa të mjaftueshme për ta mbrojtur jetën e tij (p.sh. vëzhgim më të ngushtë, masat parandaluese). Si rezultat, u gjet shkelje e nenit 2 të Konventës (E drejta për Jetë) për mosmarrje të masave parandaluese dhe hetim joefektiv.
33. Rekomandimi për ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve policorë që ishin në detyrë në kohën e rastit të vetëvarjes, edhe në mungesë të elementeve të veprës penale, tregon se janë konstatuar mangësi në përmbushjen e detyrave zyrtare. Nga perspektiva e të drejtave të njeriut, edhe neglizhenca serioze që kontribuon në krijimin e kushteve të pasigurta për personat e privuar nga liria mund të përbëjë shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës, sipas nenit 2 të KEDNj-së.
34. Nga analiza ligjore e këtij rasti vërehet se personi i ndaluar ndodhej në një mjedis ku nuk ishin respektuar standardet e kërkuara të mbikëqyrjes dhe të vlerësimit të rrezikut për personat e privuar nga liria. Në veçanti, evidentohet mungesa e monitorimit të vazhdueshëm, mosplotësimi i pozitës së mbikëqyrësit të dhomave të ndalimit, mosidentifikimi në kohë i rrezikut potencial për vetëvrasje, si dhe dokumentimi i pamjaftueshëm i gjendjes së personit të ndaluar gjatë qëndrimit në qendrën e ndalimit. Këto rrethana tregojnë mosrespektim të detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës së personave nën kujdesin e tij, siç parashikohet në nenin 25 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Për rrjedhojë, këto mangësi institucionale ngrenë shqetësime serioze lidhur me përputhshmërinë e praktikës së ndjekur me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e jetës dhe trajtimin dinjitoz të personave të privuar nga liria.
35. Për sa u përket vendimeve të GjEDNj-së, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 53, përcakton shprehimisht se interpretimi i dispozitave për të drejtat dhe liritë e njeriut bëhet në harmoni me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
36. Këto rrethana tregojnë se organizimi i sistemit të mbikëqyrjes në Qendrën e Ndalimit nuk ishte plotësisht në përputhje me standardet e kërkuara për garantimin e sigurisë së personave të privuar nga liria. Edhe pse hetimet e zhvilluara nga autoritetet kompetente nuk konstatuan elemente të veprës penale nga ana e zyrtarëve policorë, rekomandimi për ndërmarrjen e masave disiplinore tregon se janë evidentuar mangësi në përmbushjen e detyrave zyrtare.
37. Në dritën e standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e së drejtës për jetën, çdo mangësi në organizimin e mbikëqyrjes, vlerësimin e rrezikut apo dokumentimin e gjendjes së personave të ndaluar duhet të trajtohet me seriozitet të

³ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22002-12895%22%7D>

veçantë, pasi edhe neglizhenca në këto aspekte mund të cenojë detyrimin pozitiv të shtetit për mbrojtjen e jetës së personave që ndodhen nën kontrollin e tij.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

38. Avokati i Popullit konstaton se organizimi i sistemit të monitorimit në Qendrën e Ndalimit në Suharekë nuk ishte në përputhje me standardet e sigurisë të kërkuara për personat e privuar nga liria, pasi monitorimi i kamerave u realizua nga një ambient tjetër dhe nga një zyrtar i vetëm, i ngarkuar njëkohësisht me mbikëqyrjen e kamerave të qytetit dhe pranimin e thirrjeve telefonike. Kjo ka pamundësuar një mbikëqyrje të vazhdueshme, të përqendruar dhe efektive, duke ngritur çështje serioze lidhur me detyrimin pozitiv të shtetit për mbrojtjen e jetës sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
39. Avokati i Popullit konstaton se, në momentin e pranimin në ndalim, nuk u krye një vlerësim adekuat dhe i dokumentuar i rrezikut për vetëvrasje ose vetëlëndim, duke mos u identifikuar në kohë faktorët e mundshëm të rrezikut. Kjo bie ndesh me standardet parandaluese të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila kërkon ndërmarrjen e masave konkrete parandaluese kur ekziston rrezik real dhe i parashikueshëm për jetën e një personi në ndalim.
40. Avokati i Popullit konstaton se dokumentacioni policor lidhur me personin e ndaluar nuk është plotësuar në mënyrë tërësore, veçanërisht për sa u përket shënimeve për gjendjen shëndetësore dhe oraret e mbikëqyrjes, çka cenon transparencën, llogaridhënien institucionale dhe efektivitetin e çdo hetimi të mëvonshëm, në kuptim të detyrimit procedural që rrjedh nga neni 2 i Konventës.
41. Avokati i Popullit konstaton ekzistimin e mangësive organizative në organizimin e shërbimit të ndalimit, përfshirë mungesën e stafit të mjaftueshëm, mungesën e një zyrtari të dedikuar ekskluzivisht për mbikëqyrjen e personave të ndaluar, mungesën e trajnimeve për trajtimin e këtyre rasteve, si dhe mungesën e protokolleve të qarta dhe të posaçme për parandalimin e vetëvrasjeve. Këto rrethana tregojnë për mangësi institucionale në krijimin e një sistemi efektiv mbrojtës për personat nën kujdesin e shtetit.
42. Avokati i Popullit konstaton se rrethanat e rastit, të marra në tërësi, ngrenë dyshime serioze për mosrespektimin e detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës sipas nenit 2 të Konventës, si dhe për garantimin e trajtimit dinjitoz dhe jodegradues sipas nenit 3 të saj, për shkak të mungesës së mbikëqyrjes efektive, masave parandaluese dhe garancive procedurale në rastin konkret.

Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Policisë së Kosovës:

1. Të sigurohet vendosja e monitorit të kamerave brenda hapësirës së veçantë të Qendrës së Ndalimit dhe jo në ambiente ku monitorohen edhe kamerat e përgjithshme të qytetit, në mënyrë që mbikëqyrja e personave të ndaluar të jetë e drejtpërdrejtë, e vazhdueshme dhe efektive.

2. Të caktohet një zyrtar policor i veçantë, pa detyra të tjera paralele (si pranimi i thirrjeve telefonike apo mbikëqyrja e sistemeve të tjera), i cili do të jetë përgjegjës vetëm për monitorimin e vazhdueshëm të personave në ndalim.
3. Të sigurohet që të gjitha të dhënat për personin e ndaluar të jenë të plota, të përditësuara dhe të sakta, duke përfshirë gjendjen shëndetësore, trajtimin dhe çdo veprim që ndikon në sigurinë e tij.
4. Të vendosen procedura të detyrueshme për identifikimin e personave me rrezik për vetëvrasje ose vetëlëndim, duke përdorur formularë standardë për vlerësimin e rrezikut dhe marrjen e masave të menjëhershme, përfshirë trajtimin psikologjik/mjekësor dhe, në raste të rënda, transferimin në kujdes të posaçëm.
5. Të organizohen trajnime të rregullta mbi menaxhimin e rasteve me rrezik për vetëvrasje ose vetëlëndim, respektimin e të drejtave të njeriut dhe përdorimin e duhur të sistemit të monitorimit dhe dokumentacionit.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit